



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr.210/2025

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Skender Çoçaj, Kryesues, Kymete Kicaj dhe Bujar Muzaqi anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë paraqitur kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më datë 09 Shkurt 2025, në seancën e panelit të mbajtur me 29.01.2025, merr këtë:

V E N D I M

- I. Pranohet e bazuar ankesa e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, Anr.210/2025 e datës 26.01.2025
- II. Subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, i shqiptohet dënimi më gjorbë në lartësi prej 4,000.00 (katërmijë) euro,
- III. Detyrohet Subjekti Politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, që gjorbën e shqiptuar si në pikën -II-, të dispozitivit të këtij vendimi, ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij vendimi.

A r s y e t i m

Me datën 26.01.2025, PZAP-i, ka pranuar ankesën A.nr.210/2025, nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje, paraqitur kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës, në të cilën pretendon se Qendra e Lëvizjes Vetëvendosje në Pejë kanë vërejtur posterë, të vendosur në hapësirat/rrugët publike, të kandidatit për deputet nga radhët e Lidhjes Demokratike të Kosovës, LDK, Arben Gashi në hapësirat e Palestrës Sportive “Karragaçi” në rrugën UÇK, në Pejë dhe një veprim i tillë është në kundërshtim me Rregulloren Zgjedhore Nr.07/2024 për Fushatën e Zgjedhjeve, Monitorimin e Fushatës së Zgjedhjeve dhe Deklarimin Financiar, nenin 7, par.2, pika 2.4. Më tutje, parashtruesi i ankesës ka theksuar se përmes këtij veprimi subjekti përkatës, ka cenuar rëndë dispozitat përkatëse të LZP-së.

Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur fotografi që dëshmon vendosjen e posterëve në kundërshtim me rregullativën zgjedhore.

Më datë 27.01.2025, PZAP-i, e njoftoi subjektin politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) për ankesën e paraqitur kundër tyre, duke i dërguar kërkesë për përgjigje.

Ne përgjigjen në ankesë A.nr. 210/2025, theksohet se me vendosjen e materialit-posterit në hyrje pjesën e jashtme të Palestrës Sportive "Karagaq", për të cilën ka Pëlqim për shfrytëzimin e palestrës sportive për tubim zgjedhore për datën 26.01.2025, qoftë për pjesën e jashtme dhe atë të brendshmes, e që është rasti konkret ky i vendosjes se posterit të kandidatit Arben Gashi ne pjesën e jashtme, për ditën e caktuar pra 26.01.2025, dhe nga foto shihet se nga vetura kalimthi është fotografuar ai poster, i cili ka qëndruar përkohësisht deri ne mbylljen e tubimit. Pëlqimi i komunës ka qene gjeneral, qe do te thotë se te gjitha hapësirat jashtme dhe te brendshme atë dite kane qene ne dispozicion te subjektit politik LDK, rrjedhimisht edhe kandidateve për deputet për te promovuar veten e tyre përmes ndonjë materiali zgjedhor.

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës gjeti se:

Ankesa është e bazuar

Paneli, nga fotografitë e ofruara si provë nga parashtruesi i ankesës, të cilat gjenden në shkresat e lëndës, në mënyrë të padyshimtë ka konstatuar se subjekti politik LDK, ka vendosur posterin e kandidatit për deputet nga radhët e Lidhjes Demokratike të Kosovës PDK, Arben Gashi në hapësirat publike, konkretisht në hapësirat e Palestrës Sportive "Karragaçi" në rrugën UÇK, në Pejë pa pasur përkrahim adekuat për vendosjen e posterit dhe më të njëjtin veprim subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës, LDK, ka bërë shkelje të nenit 34, paragrafi 1 të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës LZP, konkretisht neni 34, paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 i LZP-së parasheh: "1. *Gjatë periudhës së fushatës, subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij, ndalohe nga bërja e ndonjëres si në vijim: 1.2 vendosja e njoftimeve, pllakateve dhe posterëve, ose përndryshe, vendosja e emrave të tyre ose e sloganeve në lidhje me fushatën zgjedhore brenda ose jashtë ndërtesave publike ose godinave, në apo mbi rrugët publike, në shenjat publike të trafikut, brenda ose jashtë hapësirave ose ndërtesave të zëna ose, ndryshe, që shfrytëzohen nga organizatat ndërkombëtare, ose brenda ose në hapësirat private pa leje e pronarëve ose shfrytëzuesve.*

Neni 120 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të LZP-së thekson se në rast se PZAP përcakton se ka ndodhur shkelje e të këtij ligji ose e rregullave të KQZ-së, mundet të vendosë një gjobë ndaj një subjekti politik, në vlerë deri në pesëdhjetëmijë (50,000.00) Euro.

Përveç kësaj një veprim i tillë sanksionohet edhe me nenin 24 paragrafi 6 nën paragrafi 6.1 Rregullës Nr.01/2024, ku përcaktohet se "subjekti politik që është përfitues i fondeve për financimin e subjekteve politike përmes Buxhetit të Republikës së Kosovës dënohet me gjobë deri në njëzetmijë (20, 000.00)euro.

Paneli, me rastin e vendosjes se gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh të gjitha rrethanat si në vijim: natyrën e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor në fjalë, shkallën dhe peshën e shkeljes, se veprimi që përben përsëritje të shkeljes për nga natyra është i njëjtë apo ngjashëm, subjektit politik që ka bërë shkelje të legjislacionit zgjedhor, apo ka bërë shkelje të legjislacionit edhe në proceset e mëparshme zgjedhore, që

konsiston në faktin se subjekti politik LDK, ka qenë i njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës.

Nga arsyet e theksuara me lart, e në kuptim të nenit 34 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2, nenit 118 paragrafi 1, neni 120 paragraf 1 nën paragrafi 1.3, të LZP-së, nenit 10 paragrafi 1, nën paragrafi 1.2 të Rregullores Nr.01/2024 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr.210/2025 më datën 29.01.2025

Kryesuesi i Panelit
Skender Ceqaj



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së.